



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202301014/12

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**Lënda:** Rekomandim për përmirësimin e akteve nënligjore në zbatim të legjislacionit të arsimit parauniversitar dhe licencave në RSH-në me qëllim mbrojtjen e fëmijëve

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR**

**QENDRËS KOMBËTARE TË BISNESIT**

**TIRANË**

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP) bazuar në nenin 13, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, (ligji nr.8454/1999) ka regjistruar me nismën e vet rastin e bërë publik në datën 06.11.2023 në emisionin investigativ "STOP", në televizionin kombëtar "Klan", të ushtrimit të dhunës ndaj të miturës 3 vjeçare me inicialet M. K., në kopshtin privat "Stinët", në rrugën "Kushtrimi i lirisë" në Tiranë.

AP-ja informon se brenda mandatit kushtetues së tij nuk mund të monitorojë, inspektojë apo të adresojë rekomandime në subjektet jopublike/private. AP-ja realizoi hetimin administrative bazuar në veprimet dhe mosveprimet e strukturave shtetërore. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit thekson se duhet të rishihet mandati i institucionit në funksion të zgjerimit të kompetncave, duke përfshirë dhe sektorin privat.

Bazuar në nenin 19 të ligjit nr.8454/1999, AP-ja filloi hetimin e pavaruar për çështjen në fjalë, duke përdorur metodologjinë e hetimit administrativ si vijon:

1. Inspektimin në terren të të gjitha veprimeve të ndërrmarra ose jo nga institucionet përgjegjëse, Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë; Komisarariatit të Policisë nr.3 Tiranë; Spitali Universitar i Traumës Tiranë.
2. Kërkimin e shpjegimeve mbi veprimet procedurale të kryera dhe fotokopjet e akteve procedurale paraprake të kryera nga Policia Gjyqësore e Komisarariatit të Policisë nr. 1 drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë.
3. Kërkimin e shpjegimeve mbi veprimet administrative të kryera për mungesën e licencës të kopshtit privat “Stinët” drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
4. Kërkimin e shpjegimeve mbi veprimet administrative të kryera për mungesën e licencës të kopshtit privat “Stinët” drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit(QKB).
5. Vlerësimin dhe analizimin e saktë të informacionit, provave, dokumentacionit dhe deklaratave të vëna në dispozicion nga institucionet e lartpërmendura veçmas, për të vërtetuar veprimet ose mosveprimet e ndërrmarra nga ana e tyre.
6. Vlerësimi i hollësishëm i të gjitha provave së bashku, për të marrë rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

Nga inspektimi në terren, për verifikimin e veprimeve apo mosveprimeve të organeve të hetimit dhe akuzës në nivel vendor, lidhur me rastin e dhunës ndaj fëmijës 3-vjeçare, u realizuan takime në Komisarariatit e Policisë nr. 1 Tiranë dhe Spitalin Universitar të Traumës Tiranë.

Në Komisarariatit e Policisë nr. 1, Tiranë u informuam se pasi kanë marrë dijeni për ngjarjen e ndodhur në kopshtim privat “Stinët” në datën 01.11.2023 oficerët e policisë gjyqësore të këtij organi kanë kryer veprimet e para hetimore, si marrjen e deklarimeve të nënës së të dëmtuarës, të punonjësve të kopshtit privat, përpilimin e vendimit për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor e dërgimin e tij në Institutin e Mjekësisë Ligjore, këqyrjen të vendit të ngjarjes, këqyrjen të pamjeve filmike, këqyrjen e marrjen e dokumenteve, etj. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, respektivisht me shkresat me nr. 8698-k prot., datë 06.11.2023 dhe nr. 8698/1-k, datë 06.11.2023. Nga ana jonë u administruan fotokopjet e këtyre dy

shkresave përcjellëse, por në dokumentet e përshkuara në to nuk janë pasqyruar datat se kur janë kryer veprimet procedurale përkatëse.

Ndërsa nga verifikimet e kryera në Spitalin Universitar të Traumës, Tiranë, u informuam se shtetësja e dëmtuar, e mitura Melisa Krasniqi, kishte dalë nga spitali në datën 06.11.2023. Gjithashtu në këtë institucion mjekësor u informuam se në datën 07.11.2023 kishte shkuar një mjek ligjor i cili kishte këqyrrur dokumentacionin mjekësor të administruar lidhur me të dëmtuarën.

Bazuar në informacionet e sipërcituara dhe verifikimin e kopjeve të dokumentacioneve të vëna në dispozicion, AP-ja konstaton se ka një mospërputhje midis informacionit të dërguar nga Komisariati i Policisë nr.1 Tiranë dhe atij të dërguar nga Instituti Mjekësisë Ligjore sa i përket periudhës kohore (datës) kur është dërguar vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të shtetases së mitur Melisa Krasniqi. Gjithashtu, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka sqaruar zyrtarisht se pretendimet e ngritura nga i ati i të dëmtuarës që për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të vajzës së tij, i është kërkuar sjellja e saj pranë IML-së, ndërkohë që e mitura ka qënë e shtruar në spital, nuk qëndrojnë. Referuar përmbajtjes së shkresës zyrtare me nr.8698-K prot. datë 06.11.2023 të Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë nëna e të miturës znj.Anxhela Krasniqi është pajisur me një vendim mjeko-ligjor.

Për shqyrtimin e këtij rasti është kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në përgjigjen e saj na ka informuar si më poshtë vijon:

*“...Nga verifikimet në indekset e kallëzimeve penale dhe statistikave të procedimeve penale për vitin 2023, rezulton se me shkresën nr.8698 prot., datë 06.11.2023 është dërguar nga Komisariati i Policisë nr.1, materiali kallëzues në lidhje me ngjarjen e ndodhur në kopshtin privat “Stinët”, ku është dëmtuar shtetësja e mitur me inicialet M.K. Në datën 07.11.2023 është regjistruar procedimi penal nr.7527 i vitit 2023, për veprën penale “Keqtrajtim i të miturës”, parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal. Nga ana e prokurorisë janë kryer veprimet procedurale, si kqyrja e pamjeve filmike, kryerja e aktit të eksperimentit mjeko-ligjor, janë marrë deklaratimet përkatëse, është caktuar masë sigurimi personale “Arrest në burg” për shtetasen Majlinda Deliaj, etj. Është administruar përgjigja e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor dhe nga prokurori i çështjes është disponuar në mospublikimin e akteve deri në përfundim të hetimeve.*

*Në lidhje me pikën e tretë, rezulton se në lidhje me veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit që kanë trajtuar rastin, është referuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore një kallëzim penal, i cili është ende në fazën e*

*verifikimeve. Në përfundim të hetimeve do të konkludohet nëse në veprimet e tyre janë konsumuar element të ndonjë fakti penal.”<sup>1</sup>*

Për sa më sipër bazuar në informacionin e dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se në lidhje me veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit, konkretisht të Komisarariatit nr.1 Tiranë që kanë trajtuar rastin, është referuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore një kallëzim penal, i cili është ende në fazën e verifikimeve. Në përputhje me nenin 14, të ligjit nr. 8454/1999, AP-ja mund të mos fillojë ose ndërpret hetimin në qoftë se e njëjta çështje është vendosur ose është në shqyrtim nga prokuroria apo gjykata.

AP-ja bazuar në interesin më të lartë të fëmijës kërkoi informacion shtesë lidhur me veprimet e kryera nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë bazuar në referimin e policisë gjyqësore në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore Tiranë, regjistruar si procedim penal nr.7734, datë 16.11.2023, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal.

Në përgjigje të shkresës së AP-së, me nr. K5/I52-10 prot., datë 21.03.2024, “*Kthim përgjigje*”, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka sqaruar si më poshtë vijon:

*“...në funksion të hetimit dhe veprës penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal, janë kryer hetime dhe administruar disa akte procedurale nga policia gjyqësore në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore Tiranë, por për një përfundim objektiv dhe të gjithëanshëm të këtij procedimi ka qënë e nevojshme për të kryer dhe disa veprime hetimore, të cilat i janë deleguar më datë 22.11.2023 policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

*Kjo çështje është në hetim dhe deri në këtë fazë të hetimit, nuk është proceduar me regjistrimin e ndonjë emri, si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet sipas kërkesave të parashikuara nga neni 287 të kodit të Procedurave Penale.*

*Në përfundim të hetimeve do t’ju njoftojmë për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje dhe të drejtën për të marrë kopje të akteve të këtij procedimi, sipas kërkesave të parashikuara nga neni 327 të Kodit të Procedurës Penale.”<sup>2</sup>*

---

<sup>1</sup> Shkresa zyrtare me nr.13258/1prot., datë 21.11.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

<sup>2</sup> Shkresa zyrtare me nr.10484 prot., datë 02.05.2024 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Lidhur me problematikën e identifikuar për mungesën e licencës së kopshtit privat “Stinët”, AP-ja bazuar në legjislacionin e brendshëm për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë është informuar nga organet e administratës publike si vijon:

1. Në përgjigjen e shkresës së AP-së me nr.K5/I52-4prot., datë 13.11.2023 “Kthim përgjigje”, Ministria e Sportit dhe Rinisë ka sqaruar se:

*“Subjekti me emrin tregtar “Kopshti Stinët” i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NIPT M22204042T, nuk është licencuar nga ministria përgjegjëse për arsimin si institucion arsimor parauniversitar privatë, i nivelit parashkollor “Kopsht”, pavarësisht se në ekstratin e regjistrimit tregtar, rezulton se fusha e veprimtarisë së këtij subjekti është “Kopsht për fëmijë”. Nga verifikimet e kryera rezulton se në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nuk është përcjellë aplikim nëpërmjet QKB-së për licencim si institucion arsimor parauniversitar privat, të llojit kopsht, në zbatim të ligjit nr.10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe udhëzimit nr.15 datë 12.07.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar.*

*Në zbatim të nenit 46 të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 69 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimit nr.99, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit të funksionit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), me vendimin përfundimtar nr.3026/4 prot., datë 09.11.2023, ka marrë masa administrative për subjektin Entela Danushi (person fizik) si më poshtë:*

- *dënimin administrativ kryesor: 1 000 000 (një milion) lekë;*
- *dënimin administrativ plotësues: Ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarisë.”<sup>3</sup>*

---

<sup>3</sup> Shkresa zyrtare me nr.7211/1prot., datë 01.12.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

2. Në përgjigjen e shkresës së AP-së me nr.K5/I52-8prot., datë 05.12.2023 “Kthim përgjigje”, QKB-ja ka sqaruar se:

*“Nga kontrolli i kryer në të dhënat e publikuara në regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, nuk rezulton që subjekti “Entela Danushi”, person fizik me NIPT M22204042T të jetë kryer aplikim për pajisje me licencë “Arsim parashkollor (kopsht)”, me kodin IX.1.A.1.”<sup>4</sup>*

Kushtetuta në nenin 57 të saj parashikon se kushdo ka të drejtën për arsimim. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas. Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se në kontekstin e ofrimit të një shërbimi të rëndësishëm publik siç është arsimi, roli thelbësor i autoriteteve arsimore është të mbrojnë shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve, duke pasur parasysh, në veçanti, vulnerabilitetin dhe moshën e tyre. Kështu, detyra parësore e autoriteteve arsimore është të garantojnë sigurinë e nxënësve për t'i mbrojtur ata nga çdo formë dhune gjatë kohës që ata janë nën mbikëqyrjen e autoriteteve arsimore (shih F.O. kundër Kroacisë, nr. 29555/13, § 82, 22 prill 2021, me referenca të mëtejshme).

E drejta për arsim është njohur dhe reflektohet gjerësisht edhe në të drejtën ndërkombëtare, konkretisht në nenin 26 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenet 13 dhe 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Fëmijët kanë të drejtë të zhvillohen dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë, ndër të tjera edhe përmes arsimit, si dhe të marrin pjesë në mënyrë thelbësore në shoqëri. Nga ana tjetër fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga të gjitha format e abuzimit, shpërfilljes dhe shfrytëzimit. E drejta për arsim përfshin gjithashtu një përgjegjësi të shtetit për të siguruar dhe krijuar kushtet për arsimimin e shtetasve, në përputhje me ligjin.

Sistemi arsimor parauniversitar në Shqipëri funksionon në kopshte, shkolla dhe institucionet plotësuese, të cilat janë publike ose private<sup>5</sup>. Institucionet arsimore private krijohen dhe funksionojnë në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve ligjore në zbatim të këtij ligji. Licencimi i institucioneve private bëhet nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL sot QKB) sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimit të ministrit përkatës.

<sup>4</sup> Shkresa zyrtare me nr.24030/1 datë 15.12.2023 të Qendrës Kombëtare të Biznesit

<sup>5</sup> Bazuar në nenin 14 të ligj nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Institucioni arsimor privat fillon veprimtarinë e tij vetëm pas marrjes së licencës<sup>6</sup>.

Bazuar në pikën 1, të udhëzimit nr.15, datë 12.7.2013, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për procedurat e posacme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare” të ndryshuar, kërkesa dhe dosja e aplikuesit për licencë, e plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim, paraqiten në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), sot QKB-ja.

Nga rrethant faktike rezultoi se subjekti me emrin tregtar “Kopshti Stinët” i regjistruar në QKB-në me NIPT M22204042T, ka filluar veprimtarinë në datën 4.10.2022, sipas ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Person Fizik”. Bazuar në *ekstratin e regjistrimit tregtar* në rastin konkret është paraqitur një kërkesë (për zhvillimin e aktivitetit privat por jo për pajisjen me licencë) nga shtetësja Entela Danushi për ushtrimin e veprimtarisë “Kopësht për fëmijë” si person fizik e identifikuar me numrin unik të subjektit NIPT M22204042T. Pra, kopshti privat “Stinët”, nuk duhet të kishte ushtruar veprimtarinë e tij pa marrë licencën nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nëpërmjet QKB-së.

Në vijim, bazuar në pikën 3 të këtij udhëzimi QKB-ja dërgon në formë elektronike në Drejtorinë për Zhvillimin e Arsimit Jopublik (DZHAI) në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi. MAS-i informon se nga verifikimet e kryera nuk është përcjellë aplikim nëpërmjet QKB-së për licencim si institucion arsimor parauniversitar privat, të llojit kopsht. Ndërkohë, QKB-ja informon se subjekti “Entela Danushi”, person fizik me NIPT M22204042T nuk ka kryer aplikim për pajisje me licencë “Arsim parashkollor (kopsht)”, me kodin IX.1.A.1.

Nga kuadri ligjor i sipërcituar AP-ja konstaton se fillimi i procesit për licencimin e subjekteve “*person fizik apo juridik*” të cilët kanë një numër NIPT-i për “*Arsim parashkollor (kopsht)*” realizohet vetëm me kërkesën e subjektit. AP-ja sjell në vëmendje se në kopësht ofrohen shërbime për fëmijë të grupmoshës nga 3-6 vjeç, të cilët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti<sup>7</sup>.

Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi nëpërmjet licencimit apo, përkatësisht, autorizimit bëhet vetëm nëse plotësohen këto dy rrethana: a)

---

<sup>6</sup> Bazuar në nenin 42 të ligj nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

<sup>7</sup> Pika 1, e nenit 54 të Kushtetutës së Republikës garanton mbrojtjen e posaçme që fëmijët dhe gratë gëzojnë nga shteti

ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt mund të cenojë jetën, shëndetin, të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, sigurinë e rendin publik, sigurinë kombëtare, konkurrencën e ndershme apo mirëfunksionimin e tregut, një të mirë publike, objektivat socialë dhe çdo interes tjetër publik të kësaj natyre; b) garantimi i përshtatshëm i interesave të përcaktuar në shkronjën "a" të këtij neni, pavarësisht ekzistencës së rregullave, të standardeve e mekanizmave vlerësues, vëzhgues dhe ndëshkues të mëpasshëm, nuk mund të arrihet pa një proces vetëdeklarimi, shqyrtimi, inspektimi e vlerësimi të përmbushjes së disa kriterëve të paracaktuara, përpara fillimit të veprimtarisë apo të kryerjes së veprimit (*neni 6 i ligjit nr. 10081/2009*).

Kryerja e veprimtarisë nga kopshti privat në mënyrë të parregullt e pa licencë, si në rastin konkret, nuk është në përputhje me standardet që duhet të ofrojë kopshti për jetën, shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve, si dhe për realizimin e objektivit social, të drejtës për arsim. Sipas ligjit të mësipërm, marrja e licencës duhet të bëhet përpara fillimit të veprimtarisë së kopshtit, që të garantohet përmbushja e kriterëve dhe kushteve të paracaktuara ligjore, në interesin më të lartë të fëmijës për t'u rritur dhe për të mësuar. Marrja e licencës është e rëndësishme edhe për procesin e monitorimit të kopshtit nga autoritetet shtetërore, të cilat kontrollojnë periodikisht përmbushjen e standardeve të licencës.

Bazuar në VKM-në nr. 538, datë 26.05.2009 të ndryshuar, licensimi i kopshteve bëhet sipas grupit III, pra në dy faza; faza e parë e shqyrtimit është aplikimi për licencë në QKB dhe faza e dytë është marrja e vendimit të licencimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës –aktualisht MAS - e cila kontrollon plotësimin e kriterëve përkatëse të posacme të licencimit. Afati i marrjes së vendimit është 2 javë. Kërkesa në QKL-aktualisht QKB- pranohet kur ajo bëhet jo më pranë se 3 muaj nga fillimi i vitit shkollor(*shih fusha IX, pjesa I, pika 7*).

QKB-ja është një institucion i krijuar nga shkrija në një e QKR-së dhe QKL-së. Si i tillë, ky institucion ka kompetencë, ndër të tjera, të trajtojë procedurat e licencimit sipas ligjeve që rregullojnë licencat, si dhe të informojë dhe këshillojë personat e interesuar për procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe procedurat e licencimit (neni 3, shkronjat “dh” dhe “f” të ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”). Për pasojë, edhe pse regjistrimi në QKB kryhet *online* punonjësit e QKB-së duhet të informojnë shtetasit se për hapjen e kopshtit duhet patjetër të kryente edhe aplikimin për licencë. AP-ja vlerëson se është e papranueshme të lejohet regjistrimi dhe zhvillimi i veprimtarisë për subjektin privat “kopësht për fëmijë” pa u kryer aplikimi dhe pajisja e subjektit me licencë nga Ministria përkatëse.



Bazuar në pikën 5, të kreut II të Vendim Nr. 99, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP)” DPAP-ja ka përgjegjësi të vlerësojë përmbushjen e kriterëve të licencimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve arsimore private në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe t’i propozojë ministrit dënimin administrative plotësues të pezullimit apo heqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë. Gjithashtu, ky institucion e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në:

- a) nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
- b) nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar;
- c) njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar publik.

Arsimi parauniversitar, si e mirë publike dhe vetjake, duhet të sigurohet përmes mbështetjes financiare të tij, nga të gjitha burimet respektive të mundshme të shoqërisë. Bazuar në këtë parim brenda funksionit ligjor të sipërcituar DPAP-ja nëpërmjet strukturave në nivel rajonal dhe vendor duhet të luaj një rol proaktiv në identifikimin e subjekteve private të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e arsimit parauniversitar. AP-ja thekson se në mënyrë të vazhdueshme punonjësit e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar duhet të realizojnë vizita monitoruese në terren për identifikimin e subjekteve private që ushtrojnë veprimtari në fushën e arsimit parauniversitar në mënyrë të paligjshme.

Në vendimin *Biba kundër Shqipërisë* GJEDNJ-ja ka vlerësuar se:

“67. (...) Në kontekstin e dhunës në shkollë, Gjykata rithekson se, në përputhje me parimet e mësipërme sipas nenit 8 që kërkon mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë dhune ose abuzimi në institucionet arsimore (shih paragrafët 58-60 më lart), dhe me standardet ndërkombëtare (shih paragrafin 28 më lart), autoritetet vendase duhet të vendosin masat e duhura legjislative, administrative, sociale dhe edukative për të ndaluar pa mëdyshje çdo sjellje të tillë kundër fëmijëve në çdo kohë dhe në çdo rrethanë, dhe në këtë mënyrë të sigurojnë tolerancë zero për çdo lloj dhune apo abuzimi në institucionet arsimore. Gjykata vëren se neni 66 i ligjit nr. 7952 për institucionet arsimore parashikon se shteti duhet të garantojë sigurinë e mësuesve dhe nxënësve, si dhe sigurinë e institucioneve arsimore dhe mjediseve të tyre (shih paragrafin 25 më lart). Gjithashtu, funksionimi i shkollave private, duke përfshirë sigurinë në shkolla të tilla, i është besuar në terma të përgjithshëm Ministrisë së Arsimit. Detyrat inspektuese të Inspektoratit Shtetëror, nën mbikëqyrjen e Ministrit të Arsimit, përfshijnë verifikimin se masat e sigurisë, planet dhe rregullat e brendshme për

parandalimin e dëmtimeve dhe sigurisë së nxënësve janë të përshtatshme dhe të respektuara në praktikë. Sipas nenit 25 të ligjit 10433, një inspektim i rastësishëm mund të kryhet, ndër të tjera, kur një aksident ose një incident ka ndikuar ose rrezikon të ndikojë në jetën ose shëndetin e individëve (shih paragrafin 27 më lart)”

Në këtë kuptim, për të garantuar të drejtën e fëmijës për arsim si në institucionet publike dhe private dhe për zbatimin korrekt të legjislacionit parauniversitar, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454/1999,

### **REKOMANDON:**

- Marrjen e masave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për ngritjen e një grupi pune për të vlerësuar mundësinë e rishikimit të Vendimit nr.538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” dhe udhëzimit nr.15, datë 12.7.2013, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare” të ndryshuar në funksion të parashikimit në këto akte të njoftimit automatik të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nga QKB-ja për të gjitha subjektet tregtare që bëjnë regjistrimin fillestar për veprimtarinë “kopësht privat”.
- Marrjen e masave nga Qendra Kombëtare të Biznesit për informimin e subjekteve private që kërkojnë të regjistrohen për ushtrimin e veprimtarisë “kopësht për fëmijë”, lidhur me detyrimin që ato kanë për të aplikuar për licencë, sipas kuadrit ligjor dhe afateve ligjore në fuqi.
- Marrjen e masave nga QKB-ja për të kontrolluar dhe identifikuar në sistemin e brendshëm të gjitha subjektet private që ushtrojnë veprimtari “Kopësht për fëmijë”, të cilët nuk kanë aplikuar për pajisjen me licencë, si dhe njoftimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për këto raste.
- Marrjen e masave nga QKB-ja për përshtatjen e sistemit të brendshëm të regjistrimit në mënyrë që regjistrimi me sukses në QKB i subjektit privat që kërkon të ushtrojë veprimtari “Kopësht për fëmijë” të kushtëzohet nga kryerja e aplikimit për licencë.
- Marrja e masave nga QKB-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për të organizuar fushata ndërgjegjësimi sa i përket licensimit të subjekteve private që ushtrojnë veprimtari në fushën e arsimit të fëmijëve.
- Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar nëpërmjet strukturave publike në nivel vendor për të luajtur një rol

proaktiv në terren në identifikimin e subjekteve private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e arsimit parauniversitar në mënyrë të paligjshme.

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

**K O M I S I O N E R**

**OLTA ALIAJ**